



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 ,9 dhe 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës 15Nr. 011-23133 e datës 06.05.2015, si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen me 03. 03. 2016, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunes miratojë këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BUJQËSI

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare në shumë prej 90.000 € (nëntëdhjetë mijë euro) për subvencionimin e Fermerëve të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

2.1 Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të subvencionimit dhe furnizimit të Fermerëve të Komunës së Lipjanit me fidane të mjedres së bashku me sistem të ujitjes , si dhe furnizim me serra sipas tabelës në vijim:

Masat dhe numri i përfituesëve	Shumat
56 (pesëdhjetë e gjashtë) përfitues me Mjedër në sipërfaqe prej 10 ari (këtu përfshihen fidane të mjedrës dhe sistem të ujitjes)	44.800 €
45 (Katerdhjetë e pesë) përfitues me Serrë në sipërfaqe prej 100 m ² (një ari).	45.000 €
Të pa parashikueshme	200 €
Totali	90.000 €

2.2 Çmimi për 10 ari fidane të mjedrës dhe sistem të ujitjes është 800 € (tetëqind euro) për një përfitues përkatësisht $800 \times 56 = 44.800$.

2.3 Çmimi për 1.0(një) ari serrë për një përfitues është 1000 € përkatësisht $1000 \times 45 = 45.000$ €

2.4 Specifikacioni për pëmishten me mjedrër

- Fidane të mjedrës "Pollka"

Sistemi i ujitjes komplet për 10 ari mjedër

- Gyp kryesor Ø 5/4.
- Ventill mbylls të gypit kryesor Ø 5/4.
- Filter Ø 5/4.
- Mbyllëse e gypit kryesor Ø 5/4.
- Ventilla mbyllës 16 mm.
- Mbyllës gyp sek. 16 mm.
- Gyp sekondar 16 mm.
- Lidhëse për gypin sekondar 16 mm.

2.5 Specifikimi i çmimeve LOT I

Nr	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi njësi pa tvsh €	Çmimi total pa tvsh €	Çmimi njësi me tvsh €	Çmimi total me tvsh €
1	Fidane Pollka	Copë	1000				
3	Gyp kryesor Ø 5/4	m'	30				
4	Ventill mbyllës të gypit kryesor Ø 5/4	Copë	1				
5	Filter Ø 5/4	Copë	1				
6	Mbyllëse e gypit kryesor Ø 5/4	Copë	1				
7	Ventilla mbyllës 16 mm	Copë	15				
8	Mbyllës gyp sek. 16 mm	Copë	15				
9	Gyp sekondar 16 mm	m'	450				
10	Lidhëse për gypin sekondar 16 mm	Copë	20				

- 1000 fidane nevojiten për 10 ari.
- Numri i përfituesve me nga 10 ari me fidane të mjedrës dhe sistem të ujitjes do të jetë 56 përfitues.
- Ofertuesit duhet t'i përfshijnë edhe shpenzimet e transportit.
- Çmimet duhet të jenë të kalkuluar me taksa doganore dhe me TVSH.

2.6 Specifikacioni për serra LOT I

- Serra "tunnel" me dimensione: gjatësia 16m, gjerësia 6m, lartësia 3.10m, gjerësia në mes mbajtësve 2.00 m,
- Themelet stop të metalta (180x150x3mm), me anker bazë (Ø 32 thellësi 500mm) dhe ankera përforcues (Ø25 mm 2 copë thellësi 500mm)
- Konstruksioni i metalit (Ø 42 mm mbajtësit themelor, Ø 25 i gypave) të gjitha gypat të zinkuara me trashësi të mureve të gypave min 2mm.
- Përgjatë tërë gjatësisë së serrës për montim dhe demontim përdoren kapëset e plastikes.
- Sistemi i ventilimit përgjatë tërë gjatësisë së serrës në lartësi 55-150 cm në të dy krahët. (hapje e dritareve në dy anët përgjatë tërë serrës)
- Dyert rrëshqitëse (1.5m x 2.2 m, 1copë) në pjesën e përparme dhe të pasme.
- Përgjatë tërë gjatësisë të jenë të vendosur gypat metalik dhe sistemi i mbështetjes së bimëve (teli mbajtës për bimë)
- Folja për mbulim të serrës të jetë antidrip 150-180µ, 4 vjeçar, e cila duhet të përmbajë aditiv special për kushtet klimatike të Kosovës.

2.7 Specifikimi i çmimeve LOT I

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi njësi pa tvsh €	Çmimi total pa tvsh €	Çmimi njësi me tvsh €	Çmimi total me tvsh €
1	Furnizim me skelet metalik të serrës dhe mbulimi me folije plastike tunel 96m ² komplet me montim	Copë					

- Numri i përfituesve për serrë do të jetë 45 përfitues.
- Ofertuesit duhet t'i përfshijnë edhe shpenzimet e transportit.
- Çmimet duhet të jenë të kalkuluara me taksa doganore dhe me TVSH.

Neni 3

Procedurat e blerjes së fidaneve të mjedrës me sistem të ujitjes dhe serrave do të zhvillohen nëpërmjet procedurës së prokurimit publik

Neni 4

4.1 Pas përfundimit të procedurave të prokurimit publik – përzgjedhjes së operatorëve ekonomik, do të bëhet shpallja publike për aplikim.

4.2 Pas përfundimit të afatit për aplikim me Vendim të Kryetarit të Komunës do të formohet Komisioni për përzgjedhjen e përfituesve .

4.3 Pas përzgjedhjes së përfituesve me Vendim të Kryetarit të Komunës do të formohet Komisioni për shpërndarjen e fidaneve të mjedres me sistem të ujitjes dhe serrave.

4.4 Komisionet e cekura në paragrafin 4.1 dhe 4.2 të këtij neni gjatë punës së tyre do të mbajnë procesverbal dhe do të përgadisnin raport me shkrim të cilin do t'ia dorëzojnë Kryetarit të Komunës dhe një kopje Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

4.5 Punët administrative - juridike për Komisionet e cekura do ti kryej Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 5

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2016.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Prokurim

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 400-12011

Lipjan, më 04. 03. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

